

**Jusuf OSMANI**

**KRIMET SERBE NDAJ FËMIJËVE NË KOSOVË  
(1998-1999)**

Në Kosovë në luftën e fundit të agresorit serb, më 1988-1999 kanë ndodhur krime barbare aq të tmerrshme mbi civilët shqiptarë, që ushtruan pa mëshirë pjesëtarët e forcave policore, ushtarake e paramilitare serbe, ku nuk kursyen as fëmijët, as foshnja, as gratë shtatzëna. Dëshmitë për krimet e luftës, vrasjen e fëmijëve, grave, pleqve, të rinjve etj. në Kosovë, janë grumbulluar gjatë hulumtimeve që janë bërë gati në çdo vendbanim të Kosovës ku kanë ndodhur krimet, si dhe të dhënat nga bashkëpunëtorët e shumtë, të dhënat e komunave dhe të disa asociacioneve të tjera.

Krimet në Kosovë i kanë paraprirë dhe nxitur propaganda dhe gjuha fyese, urrejtja dhe diskutimet e shumta të politikanëve serbë në organet më të larta shtetërore e qeveritare në mitingjet e shumta antishqiptare në Kosovë dhe jashtë Kosovës, planet e Akademisë Serbe të Shkencave, shkrimet e gazetave ditore, mediat elektronike, si dhe botimet “shkencore” të dirigjuara një kohë të gjatë, etj. Rol të theksuar ka luajtur Kisha Ortodokse Serbe dhe priftërinjtë e saj, të cilët i inkurajonin dhe i bekonin kriminelët për vepra të tilla “të shenjta”, siç i quanin ata e të cilat i bënë në emër të serbizimit, ortodoksizmit dhe Shën Savës.<sup>1</sup> Masakrimet, vrasjet masive të burrave, grave, fëmijëve, pleqve e të tjerë, dhunimet e vajzave dhe të grave të reja, djegiet dhe shkatërrimet masive të vendbanimeve, të ekonomisë dhe pronës, nuk u mjaftonin forcave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, por për t’i humbur gjurmët e krimeve hapnin varreza masive dhe individuale akoma të painedifikuara (N.N), në Kosovë dhe në Serbi. Ka shumë raste kur kufomat janë varrosur, por pas disa dite janë zhvarrosur dhe dërguar në vende të panjohura.

---

<sup>1</sup> Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë në Kosovë, 1998-1999*, Libri I, f. 607, Libri II, (ribotim, i plotësuar), Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës, Prishtinë, 2012, f. 16; Jusuf Osmani, *Serb Government’s Crimes in Kosova 1998-1999*, Book 1, Book 2, Prishtinë, 2016, f.16; Jusuf Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë, 1998-1999*, Prishtinë, 2013, f. 32.

Nataliteti më i lartë te shqiptarët në Kosovë në krahasim me viset tjera të ish-Jugosllavisë ishte temë e shkrimeve negative në propagandën zyrtare serbe. Thuhej se ai është pjesë e politikës së paramenduar që të shtohet popullsia shqiptare. Kjo i kishte nxitur shumë paramilitarë serbë që të bënë vrasje edhe në fëmijë. Por, me të gjitha normat ndërkombëtare në botë si në paqe edhe në luftë, fëmijët janë të mbrojtur.

Forcat e armatosura serbe edhe përkundër Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (1989)<sup>2</sup> dhe Deklaratës Botërore për Mbijetesën, Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Fëmijëve (1990), në fund të shekullit XX në Kosovë, kundër popullit shqiptar, posaçërisht kundër fëmijëve kanë zbatuar kampanjë të koordinuar, afatgjatë, gjithëpërfshirëse dhe të fortë duke shtënë e grasatuar. Ku përveç shumë civilëve dhe popullatës civile, shumë fëmijë janë keqtrajtuar, vrarë dhe plagosur.<sup>3</sup> Fëmijët shqiptarë jo vetëm që nuk ishin të kursyer nga dhuna shoviniste, por në të kundërtën, ata posaçërisht ishin në shënjestër. Ishin në shënjestër të forcave serbe me motivacion se ata ishin “*armiq të ardhshëm të Serbisë*”. Kështu llogariteshin edhe foshnjat në djep dhe në gjë të nënës. Në bazë të ekspertizave mjekësore është konstatuar se shumica e viktimave ishin ekzekutuar nga afër, ndërsa një numër jo i vogël janë masakruar edhe me armë të ndryshme të ftohta. Në mesin e trupave të shqiptarëve të gjetur në varrezat masive në Batajnicë, një numër i madh i trupave ishte i grave dhe fëmijëve.<sup>4</sup>

Gjatë kohës së luftës së agresorit serb sikurse të rriturit, edhe fëmijët shqiptarë janë vrarë me mjete të llojllojshme luftime, përmes granatimeve, bombardimeve, vrasjeve nga afërsia me armë zjarri dhe armë të ftohta, etj. Fëmijët janë vrarë në vende të ndryshme të Kosovës, në shtëpi, në rrugë, në pyll, në strehimore të improvizuara, në kolona, në mjete transporti gjatë ikjes, etj. Struktura e fëmijëve të vrarë ishte e moshave të ndryshme dhe e të dy gjinive. Krimet, masakrat dhe dhuna e ushtruar ndaj popullatës shqiptare, posaçërisht ndaj fëmijëve në Kosovë në periudhën 1998-1999 janë më të rëndat dhe më tragjike në Evropë. Ka shumë raste e dëshmi se si forcat serbe, kanë marrë në shënjestër e vrarë, madje edhe masakruar fëmijët shqiptarë. Fëmijët janë vrarë sepse shiheshin si luftëtarë potencialë të UÇK-së. Forcat paramilitare serbe vetë deklaroni se fëmijët, nëse rriten, do të hakmerren. Vrasja e fëmijëve të pafajshëm e të paafte për vetëmbrojtje dëshmon për urrejtjen e sulmuesit. Fëmijët dhe gratë masakroheshin dhe

<sup>2</sup> Kombet e Bashkuara, Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve, 20 nëntor 1989; Deklarata Bota e respektueshme ndaj fëmijëve, 2002; Universitet u Sarajevo, Institut za istrazivanje zlocina protiv covecnosti i medjunarodnog prava, Sarajevo, Zlocini nda djecom u opsadi, Sarajevo, 2010, f. 18.

<sup>3</sup> Jusuf Osmani, Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë..., f. 57.

<sup>4</sup> *Po aty*, f. 58-59.

ekzekutoheshin nga forcat serbe po sikur të rritur. Ka shumë raste kur fëmijët janë vrarë në mënyra më mizore. Madje, janë masakruar edhe foshnjat e palindura, në bark të nënave, ose ata të posalindurit. Ata janë marrë dhe vrarë para prindërve ose prindërit janë vrarë para tyre. Kishte raste të shumta kur fëmijët merreshin pengë për përfitime materiale, ndërsa disa fëmijë femra ende të mitura janë dhunuar.

Vrasjen e fëmijëve të shumtë e dëshmon numri i madh i fëmijëve të vrarë në regjistrin e personave të vrarë dhe të masakruar nëpër tërë Kosovën.<sup>5</sup> Fëmijët shqiptarë të Kosovës gjatë luftës së agresorit pushtetar serb në mënyrë sistematike dhe masovikisht e individualisht janë vrarë dhe plagosur. Duke u bazuar në numrin e madh të fëmijëve të vrarë, mund të konstatohet se ndaj fëmijëve shqiptarë të Kosovës janë bërë akte të planifikuara, të organizuara dhe sistematike me qëllim të asgjësimit të shqiptarëve, në aspektin nacional, etnik dhe fetar. Karakterin e vërtetë kriminal dhe gjenocidial të fushatave ushtarako-policore pushtetare serbe në Kosovë në vitet 1998-1999 e dëshmon qartë numri i madh i fëmijëve të vrarë dhe të masakruar në format nga më të ndryshmet dhe nga më të tmerrshmet. Statistikat e organizatave humanitare ndërkombëtare, që kanë vepruar në Kosovë, në fund të vitit 1999, kanë publikuar të dhënat e tyre se si pasojë e luftës 27 000 fëmijë kanë mbetur jetimë, 12 000 prej të cilëve pa asnjërin prind.

Gjatë luftës në Kosovë (1998-1999), nga organizatat e ndryshme humanitare është konstatuar se 12% e viktimave të luftës janë fëmijët dhe se 5% e viktimave të fëmijëve në Kosovë është më e lartë se ajo e të gjitha vendeve të pushtuara nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore. Numri i përgjithshëm i të vrarëve në Kosovë të nacionalitetit shqiptar dhe ndonjë i nacionalitetit boshnjak, turk e rom arrin shifrën prej 11 507 viktimave (9 793 meshkuj dhe 1 714 femra). Sipas të dhënave të grumbulluara për numrin e fëmijëve të vrarë dhe të pagjetur, por të rënë edhe dëshmorë në Kosovë në periudhën janar 1998 - 12 qershor 1999 janë gjithsej 1 284 fëmijë, të rinj deri 18 vjeç. Ndërsa, deri në moshën 5-vjeçare kanë pësuar 299 fëmijë, duke mos llogaritur ata të cilët kanë vdekur menjëherë pas lindjes dhe nuk ishin të pagëzuar, si dhe ata në bark të nënës së vrarë. Duhet përmendur se më 12 dhjetor të vitit 1998 nga shërbimi sekret serb, në kafenenë e quajtur “Panda” në Pejë janë vrarë 6 persona serbë, prej tyre 5 fëmijë, me qëllim që të akuzohen pjesëtarët e UÇK-së se kinse ata po bëjnë krime edhe ndaj fëmijëve.<sup>6</sup> Duke u bazuar në të dhënat e grumbulluara më së shumti fëmijë të vrarë dhe të pagjetur janë në komunën e Skënderajt 186

<sup>5</sup> *Po aty*, f. 58.

<sup>6</sup> [Masakr u kaficu Panda – Wikipedijs / Википедија \(wikipedia.org\)](https://en.wikipedia.org/wiki/Masakr_u_kaficu_Panda)

fëmijë, në atë të Drenasit 151 fëmijë, të Gjakovës 122 fëmijë, Prizrenit 85 fëmijë, Rahovecit 89 fëmijë, Suharekës 77 fëmijë, Malishevës 77 fëmijë, Vushtrisë 60 fëmijë, Klinës 51 fëmijë, Pejës 52, Mitrovica 41, Prishtina 33, Istogu 23, Deçani 37 etj. Ndërsa, të pagjetur ende më së shumti janë në komunën e Suharekës 28 fëmijë. Në këtë luftë sipas burimeve serbe kanë pësuar 16 fëmijë të nacionalitetit serb.<sup>7</sup> Shumë femra shqiptare që ishin shtatzëna pësuan në luftën e agresorit serb. Disa prej tyre edhe u vranë, që mund t'i quajmë vrasje të dyfishta. Regjistrimi i femrave shtatzëna që u vranë në luftë ishte mjaft i vështirë, sidomos ato që ishin në muajt e parë të shtatzanisë. Numri i tyre është i madh, mirëpo, kemi arritur që t'i regjistrojmë një numër të vogël të tyre, ato që ishin në muajt e fundit të shtatzanisë. Janë regjistruar 16 nëna.

Ekzistojnë shumë dëshmi për vrasje të fëmijëve. Një “raport i brendshëm”, i cilësuar “tepër sekret”, i hartuar nga shërbimet sekrete të Ushtrisë Jugosllave, në janar/shkurt të vitit 2000, jep një pamje të përmasave të krimeve të tmerrshme që kryen forcat ushtarake serbo-jugosllave gjatë pranverës së vitit 1999 në Kosovë. Veçanërisht tronditëse ishin dëshmitë për vrasjen e fëmijëve. “*Dëshmitë e përbashkëta të oficerëve në terren, tregojnë se njësitë e Ushtrisë Jugosllave kanë qenë përgjegjëse për vdekjen e të paktën 800 fëmijëve shqiptarë nën moshën 5-vjeçare*”.<sup>8</sup>

Raporti ishte publikuar nga gazetari Miroslav Filipoviq nga Kraleva. Në artikullin e tij për IWPR-në, “Oficerët serbë tregojnë krimet”, i botuar më 4 prill 2000, Filipoviq ka cituar këtë raport tepër sekret mbi krimet e luftës në Kosovë, të cilin ushtria jugosllave e nxori në pranverë të vitit 2000, në përpjekje për të ndalur Slobodan Millosheviqin që të mos shkaktonte konflikt të ri në Mal të Zi. Dokumenti tepër sekret paraqet një pamje shumë të errët të oficerëve të “Ushtrisë Jugosllave”, të cilët kanë treguar për krimet e tmerrshme të kryera nga Ushtria Jugosllave në Kosovë gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s.<sup>9</sup> Siç del nga ky dokument, për shumë nga oficerët, propaganda që bën Beogradi është e pavërtetë dhe e pabesueshme. Komandanti i një njësie tankiste ka hedhur poshtë pretendimet e pavërteta serbe se fushatat e Kosovës kishin për synim shtypjen e “separatistëve” shqiptarë, duke thënë: “*Gjatë gjithë kohës sa kam qenë në Kosovë nuk kam*

<sup>7</sup> Të dhënat e marra për fëmijët e vranë gjatë vizitës së vendbanimeve të Kosovës, viti 2008-2012.

<sup>8</sup> IWPR - Raporti i Krizës së Ballkanit: Miroslav Filipoviq, *Oficerët serbë kujtojnë vrasjet* (BCR Nr. 130, 4 prill 2000; Fitnete Ramosaj, *Krimet serbe në Kosovë, Pa Apologji 2*, Me fakte kundër shpifjeve, Anatema, Prishtinë, 2008, f. 336.

<sup>9</sup> Miroslav Filipoviq, *Oficerët serbë kujtojnë vrasjet* (BCR Nr. 130, 4 prill 2000; J. Osmani, *Serb Government's Crimes in Kosova 1998-1999*, Book 1, Prishtinë, 2016, f. 68.

parë asnjë ushtar armik dhe njësia ime nuk është përfshirë asnjëherë në luftime apo nuk ka hapur zjarr ndaj objektivave ushtarake. Tanket moderne janë dërguar kundër fshatrave të pambrojtura shqiptare. Tanket, që kushtojnë 2.5 milionë dollarë amerikanë secili, janë përdorur për të masakruar fëmijë shqiptarë”, - ka thënë ky oficer, për të përfunduar se për të gjithë këtë “më vjen turp”.<sup>10</sup> Një oficer tjetër, i quajtur Drazhen, i cili ka marrë pjesë në luftë në Kosovë, kujton: “Kam parë me sytë e mi se si një rezervist rreshtoi para një muri rreth 30 gra dhe fëmijë shqiptarë. Mendova se ai donte vetëm t’i frikësonte ata, por pastaj shkoi pas një mitralozi të rëndë kundërajror dhe tërhoqi këmbëzën. Plumbat 12 milimetrësh i këputnin në mes trupat e tyre. Më dukej si një skenë e ndonjë filmi aksion, por në fakt ajo ndodhi me të vërtetë”. Drazheni përfundon: “Nuk e di se si do të jetoj me këto kujtime, se si mund t’i rris fëmijët e mi. Unë dëshiroj t’i shoh para gjykatës ata që kanë kryer këto krime”.<sup>11</sup>

Karakteristike është vrasja e Fidan Jetullah Bekajt nga Likoci i Skënderajt. Familja kishte lëshuar shtëpinë dhe ishin vendosur me shumë refugjatë të tjerë në fshatin Krasmiroc. Më datën 24 shtator 1998, ushtarët serbë me kokat e lidhura me shami dhe fytyra të ngjyrosura e rrethuan fushën ku ishin refugjatët. E ndërморën bastisjen e refugjatëve, u morën të gjitha gjërat e vlefshme, u urdhëruan që të shkonin drejt Krasmirocit. Një ushtar e ndau Fidanin nga kolona. I ati e luste ushtarin që ta lëshonte atë, duke thënë se Fidanin e kishte djalë hasreti dhe se ai ishte shumë i ri. Ushtari reagoi duke e qëlluar me kondak në kokë. E çuan Fidanin në pyll, ndërkaq civilëve u thanë të hynin në një zgafelle. I ati i Fidanit sërish e luti një ushtar tjetër që t’ia lëshonin të birin. Ushtari shkoi në pyll dhe u kthye duke i thënë prindërit se “djali ka mbaruar”.<sup>12</sup> Përkitazi me vrasjen e familjes së Selatin Gërzhaliut në Studime të Poshtme të komunës së Vushtrrisë, më datën 31 maj 1999 ku pothuajse të gjithë ishin fëmijë, një i afërm i tij, që kishte shkuar për ta thirr policinë në Vushtrri dhe kishte ardhur të hetonte në vendngjarje kishte deklaruar: “Policët dhe gjykatësi hetues erdhën e bënë fotografi. Na thanë që do të na japin kopje të fotove, gjë që nuk ndodhi. Kur hyra brenda, gjykatësi hetues, një grua nga Mali i Zi, ia plasi së qarës. Njëri nga policët e pyeti, pse po qante. Gruaja tha: “Po fëmijët, çfarë kanë bërë?”. Njëri nga policët, Dragan Petroviq ia

<sup>10</sup> Miroslav Filipoviç, *Oficerët serbë kujtojnë vrasjet...* ; Mikel Ndreca, 87 vjet terror dhe gjenocid shtetëror (1912-1999), Prishtinë, 2001, f. 336.

<sup>11</sup> M. Filipoviç, *Oficerët serbë kujtojnë vrasjet...* ; Fitnete Ramosaj, *Krimet serbe në Kosovë, Pa Apologji 2, Me fakte kundër shpifjeve*, Anatema, Prishtinë, 2008, f. 140.

<sup>12</sup> Libër Kujtimi i Kosovës, 1998-2000, Fondi për të Drejtën Humanitare, Prishtinë, 2011, f. 401.

ktheu: “Kjo është luftë, shoqe”. Unë i thashë atij: “Lufta është burrat me burrat, kështu që po ua mbajti shko në pyll dhe lufto me UÇK-në. Këta janë fëmijë që i kanë vrarë në gjumë”. Petroviqi pa nga unë, por nuk më foli. Pasi bënë fotografitë, thanë se do t’i varrosnin të vrarët, sepse do të sillnin njerëz nga Mitrovica. Ata shkuan në Vushtrri me veturë, por më pas u kthyen dhe na thanë neve që t’i varrosim të vrarët”.<sup>13</sup>

Xhemal Avdullahu nga Popoci i Gjakovës, të cilit në luftë iu vranë tre djem dhe dy të tjerët i vuajtën burgjeve të Serbisë, edhe sot e mbulojnë djersë të ftohta dhe rrëqethet kur kujton 27 prillin e vitit 1999. Atë ditë me familje gjendej në fshatin Sheremetaj, ku ishin dëgjuar britmat “Po vjen ushtria serbe!”. “Po vij në njësitë e Arkanit”. Popullatën e tmerruar po e grumbullonin dhe dëbonin në drejtim të Gjakovës. Derisa me qerre me kalë po udhëtonte bashkë me familjen në kolonën e të dëbuarve, afër Mejës, i ndaluan forcat ushtarako-policore serbe. Një ushtarak, me fytyrë të ngjyrosur, ua rrëmbeu nga duart mbesën 4-vjeçare, Edonën. E kapi për flokësh, e ngriti lartë dhe ia vuri thikën në fyt, duke kërkuara para në këmbim të saj. Edonën e lëshoi pasi Xhemajli ua dha paratë (marka gjermane) aq sa kërkuan. Sapo e lëshuan Edonën, ia rrëmbyen djalin 15-vjeçar, Imerin. “O babë, pashë Zotin mos më lë!”, - bërtiste me sa zë që kishte duke iu ngjitur për gjoksi për të mos u shkëputur nga babai. Xhemajli tenton t’u japë sërish para, por paratë nuk bëjnë punë më. “Merrmëni mua në vend të tij, e lëreni këtë se është fëmijë”, - u thotë. Por jo “me ty kemi krye punë”, - ia kishte kthyer njëri prej tyre, me uniformë kamuflazhi e maskë në fytyrë, që dukej se i njihte mirë. Djalin ia mënjanoi te grupi i të ndaluarve, që më pas u ekzekutuan, të tjerët i urdhëruan të vazhdojnë rrugën... “O babë, mos më le, pashë Zotin mos më le...”, - edhe sot i tingëllon thekshëm zëri i të birit që i vinte nga prapa. Dy vjet më parë, mbetje eshtrash të Imer Abdullahun (15) janë sjellë nga varrezat masive të Serbisë dhe janë varrosur në Mejë.<sup>14</sup>

Në një emision televiziv në kanalin EXP-Historia, datë 1 shtator 2011, në ora 21:30, emision i përgatitur nga BBC, producent Fiona Murch, përkritazi me krimet e Serbisë, përkatësisht të Sllobodan Millosheviqit, në deklaratën e një dëshmitari i quajtur Boshko, inspektor policie, në mes tjerash ai tregon për mënyrën e vrasjes dhe të bartjes së kufomave nga komuna e Suharekës në Serbi dhe varrosjen në Batajnicë, hedhjen e kufomave në lumin Danub, etj. Ai thotë se: “viktimat janë mbytur edhe me

<sup>13</sup> Human Rights Watch, Nën pushtetin e urdhrave, Krimet e luftës në Kosovë, New York, Washington, London, Brussels, 2001, f. 442.

<sup>14</sup> F. Ramosaj, *Krimet serbe në Kosovë...*, f. 143-144.

*mjete të forta, si çekan e forma tjera*”. Në pyetje të reporterës se a është vepruar në mënyrë të njëjtë edhe me fëmijët. Ai u përgjigj se po. Ai kujton bartjen e viktimave me kamion, në mesin e tyre edhe fëmijë, e ende përkujton emrat e Natyrës (1981) dhe Emirit (4-vjeçar).<sup>15</sup>

Fëmijët janë vrarë në kolona, në prehër të nënës, siç është rasti me Edon Musli Osmanin nga Sllatina e Madhe e Fushë-Kosovës, i lindur më 28.07.1986. Më datën 12 prill 1999 në fshatin Qerim të Gjakovës familja e tij duke ikur për në Shqipëri, nga një paramilitar serb doli në rrugë, në prehër të nënës Hanumshahes shtiu nga afërsia në Edonin, duke e vrarë atë, ndërsa nënën e tij duke e plagosur rënd.<sup>16</sup> Rast pothuajse i njëjtë është vrasja e Fitim Rustem Gudaçit (1992) nga Stagova e Kaçanikut. Ai u vra më datën 21 maj 1999 në Stagovë, në prehër të nënës. Me të njëjtin plumb u plagos nëna e tij.<sup>17</sup> Po ashtu edhe rasti i vrasjes së Hasan Pacollit 9-vjeçar nga Prishtina, ku më datën 30 mars 1999, në Prishtinë e vrasin paramilitarët në prehër të nënës Elmaze që ishte nisur me veturë për të ikur në Maqedoni. Në veturë plagosin edhe 4 persona të tjerë dhe një fëmijë, Agroni 12-vjeçar.<sup>18</sup> Ka pasur edhe shumë raste të tjera të tilla.

Në Analizën e OSBE-së,<sup>19</sup> janë publikuar disa të dhëna, bazuar në deklaratat e dëshmitarëve për vrasjet makabre të fëmijëve, siç janë: në fshatin Grabovc i Epërm, komuna e Obiliqit, forcat serbe i kanë grumbulluar fshatarët në një oborr. Një familje ka tentuar të ikë. Kur është zënë, ushtarët para prindërve ia kanë heq kokën një fëmijës; po ashtu një dëshmitar kishte deklaruar se në Mitrovicë, para prindërve, pjesëtari i forcave paramilitare ia ka hequr kokën një fëmijës trevjeçar; një person tjetër tregon se ishte dëshmitar, kur në rrugën Pejë-Deçan, kah mesi i muajit prill (1999 J.O.), tre njerëz të armatosur, që si duket ishin pjesëtarë të njësive paramilitare serbe, e kanë ndaluar një shqiptare të Kosovës. Ajo udhëtonte këmbë me fëmijën e saj që ishte pesë ose gjashtëvjeçar. E kanë pyetur se ku e ka burrin, ajo iu është përgjigjur se nuk e di. I kanë thënë se nëse dëshiron ta shpëton fëmijën, burri i saj duhet “*të vizatohet këtu*”. Atëherë ia kanë grabitur fëmijën. Njëri nga ushtarët (paramilitarët J.O), i ka thënë atij që e mbante fëmijën “*Çka po flet me të, vraje*”. Kështu që ushtari së pari e ka prerë djalin dhe më pastaj ia ka hequr kokën.

<sup>15</sup> J. Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë...*, f. 65.

<sup>16</sup> Deklaratë e prindit Musli Hamdi Osmanit, nga Sllatina e Madhe, Fushë-Kosovë, qershor 2000.

<sup>17</sup> Rrëfim Fikrije Tusha-Gudaqi, e lindur më 19 maj 1968, 10 prill 2001.

<sup>18</sup> Ali Sh. Berisha, *Flijimet për tokën e lirë* (Sacrifices for a free land), Prishtinë, 2002, f. 206.

<sup>19</sup> Analiza OEBS Verifikacione misije Kosovo. Stanje ljudskih prava oktobar 1998 – jun 1999 godine. Fond za humanitarno pravo, Edicija Dokumenta, Beograd, 2004.

Një dëshmitar tregon se e ka parë fëmijën e moshës diku 2-3 vjeçar, të vënë në një dru, në rrugën Prishtinë-Koliq. Në dru ishin të shkruar këto fjalë: *“Kjo është Serbi. Kështu do t’ua bëjmë të gjithë shqiptarëve, sepse unë jam Zot, dhe NATO nuk do të thotë asgjë”*. Një i ri 22-vjeçar deklaroi se e ka parë kur një polic serb e ka therë me thikë një grua, së pari një njërën dorë dhe pastaj tjetrën, kështu që foshnja dymujore i bie nga duart, polici menjëherë ka shtirë në të. Në këtë analizë përshkruhen edhe raste të tjera makabre, si p.sh. vrasjen e mësuesit dhe të tre fëmijëve në fshatin Padalishtë të Istogut, goditjen me çekan të një fëmije në Mitrovicë, më 16 prill 1999, në konvojin e refugjatëve nga Peja, iu është marrë foshnja pesëvjeçare nga duart e prindit.<sup>20</sup> Kështu, nënat shqiptare më 1998-1999 kanë përjetuar momentet më trishtuese të vrasjes së fëmijës së saj në prehër, në djep e gjetiu. Ajo është treguar heroinë edhe në të kaluarën historike, se edhe nacionalisti serb V. Çubrilloviq kishte deklaruar: *“na ka mundur nëna shqiptare”*, andaj edhe në luftën e fundit, në shënjestër ishin fëmijët.

---

<sup>20</sup> J. Osmani, *Krimet e Serbisë ndaj fëmijëve në Kosovë...*, f. 67-68.